

UDHA ISLAMIE

Viti XIII - Nr. 5 (147), Maj, 2015

E përnuajshme Informativ - Fetare - Kulturore - Edukative

Botim i Myftinisë Shkodër

NËN ÇATINË SHPIRTËRORE TË MË TË DASHURIT TË ZOTIT

*“Zemërimi, urrejtja,
mosmarrëveshjet
dhe përplasjet
nuk mund ta mbajnë
gjallë një shoqëri.
Ne kemi nevojë
për modelin
dhe shembullin
e Profetit Muhammed,
modelin e paqes
dhe mirësisë.”*



Skender Bruçaj
Kryetar i KMSH

Sot jemi mbledhur të gjithë së bashku nën çatinë shpirtërore të më të dashurit të të gjithë myslimanëve, jemi mbledhur nën atmosferën shpirtërore të përvjetorit të lindjes së Profetit Muhammed, paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të! Ne besojmë se çdo vend ku përmendet emri i tij, mbushet plot dritë, plot mëshirë e plot dashuri.

Ajetet kur'anore e përshkruajnë atë si mëshirë për botët. Kjo sigurisht që është një dhunti, një mirësi dhe urtësi, por në të njëjtën kohë është dhe një përgjegjësi të cilën Profeti Muhammed (a.s) e përfaqësoi në mënyrën më të bukur, duke u bërë shembulli më i shkëlqyer, ku njerëzimi të frymëzohet, të motivohet, si dhe të referohet për të mirën, të drejtën dhe virtytet.

Unë personalisht i konsideroj programet festive në përkujtim të Profetit (a.s) si rifreskim dhe riformim të marrëdhënies sonë me të; duke rigjallëruar në mënyra të ndryshme kujtimin e tij të vyer, ne rifreskojmë besën me të. Për këtë arsye ne e kujtojmë sot përsëri, në këtë bashkësi të madhe, e përkujtojmë dhe e përshëndesim me dashuri e admirim të thellë.

Ai për ne është si një burim me ujë të kthjellët në zemër të shkretëtirës, si një rreze drite në errësirën e paanë. Me mëshirën e tij, një çelës profetik në duart e Hz. Muhamemdit (a.s), ai hapte zemrat e ngurtësuara dhe të ndryshkura, duke ndezur tek ata pishtarin e besimit.

Kur'ani e përshkruan atë si një shembull morali të lartë, teksa thotë: "Padyshim ti je me virtyte madhore."

NËN ÇATINË SHPIRTËRORE TË MË TË DASHURIT TË ZOTIT

- (Kalem, 4). Profetët kanë qenë monumente të një morali të përkryer për popujt, për bashkësitë ku janë dërguar dhe për gjithë njerëzimin. Nëse në një shoqëri pakësohen personat e virtytshëm, ajo shoqëri është e destinuar drejt humbjes. Një shoqëri e shkatërruar moralisht është e shkatërruar shpirtërisht dhe materialisht.

Prandaj themi se përkujtime të tilla nuk janë ditë të thata përkujtimi, por janë ditë prove të moralit tonë individual dhe shoqëror përballë moralit të Profetit tonë, Muhammedit (a.s).

Dashuritë e mëdha kërkojnë shpirtëra të përkushtuar dhe i Dërguari i Zotit ishte shpirti më i përkushtuar.

I Dërguari i Allahut na fton të jetojmë dhe të dhurojmë jetë. Na thërret të gjallërojmë njeriun dhe njerëzimin. Mesazhi i profetëve është jeta, të jetosh dhe t'i bësh të tjerët të jetojnë. Por fatkeqësisht, sot në botë, në shumë vende shohim vetëm grindje, përleshje, dhunë e mizori.

Të nderuar motra dhe vëllezër!

Dhuna nuk është rruga jonë.

Ekstremizmi nuk është rruga jonë.

Radikalizmi nuk është rruga jonë.

Profeti predikoi vetëm paqe dhe dashuri, rruga e tij është rruga e jetës, e dashurisë; rruga drejt unitetit për një jetë të paqte dhe në harmoni me njëri-tjetrin. Prandaj le të respektojmë kujtimin e Profetit (a.s) e të ringjallim mes nesh dhembshurinë, mëshirën dhe respektin.

Të nderuar të pranishëm, të dashuruar pas të Dërguarit të Zotit, të lidhur pas mirësisë, bukurisë dhe respektit, miq të zemrës dhe mysafirë të nderuar.

Ju shpreh falënderimet e mia më të sinqerta për pjesëmarrjen tuaj. Le të bëhet kjo ditë, motiv i vëllazërimit, dashurisë, paqes dhe lumturisë. Të tregohemi të dhembshur, të duruar, të sjellshëm dhe tolerantë.

Zemërimi, urrejtja, mosmarrëveshjet dhe përplasjet nuk mund ta

mbajnë gjallë një shoqëri. Ne kemi nevojë për modelin dhe shembullin e Profetit Muhammed (a.s), modelin e paqes dhe mirësisë. Duke ndjekur shembullin që ai la pas, le të ndërtojmë të gjithë së bashku dhe secili në veten e tij, një botë të paqte, me dashuri e respekt për jetën dhe për të gjitha krijesat!

Kurrë mos e humbni shpresën nga Zoti i Madhëruar dhe lutjuni Atij për mirësi e begati.

*AI PËR NE ËSHTË
SI NJË BURIM ME UJË
TË KTHJELLËT NË ZEMËR
TË SHKRETËTIRËS,
SI NJË RREZE DRITE
NË ERRËSIRËN E PAANË.
ME MËSHIRËN E TIJ,
NJË ÇELËS PROFETIK
NË DUART
E HZ. MUHAMEDIT ((A.S)),
AI HAPTE ZEMRAT
E NGURTËSUARA
DHE TË NDRYSHKURA,
DUKE NDEZUR TEK ATA
PISHTARIN E BESIMIT.*

Ju përshëndes me dashuri dhe respekt.

Zoti ju bekoftë ju, familjet tuaja dhe Shqipërinë tonë të shtrenjtë.

Ju faleminderit!

Fjala e plotë e Kryetarit të KMSH-së, z. Skender Bruçaj në programin e 10-të festiv "Profeti Muhammed (a.s) - Krenaria e Njerëzimit", organizuar në Pallatin e Kongreseve nga Komiteti Mysliman i Shqipërisë, më 25 prill 2015.



Dr. Muhamed V. Sulejman

Nëse nuk mund të jetë e habitshme, që nganjëherë disa murida (dashamirës) të dijetarëve, apo klerikëve sillen ndaj tyre me një sjellje shenjtërie edhe në mënyrë të ashpër, apo jo të pëlqyeshme, kjo është diçka që nuk ka munguar në asnjë kohë, në asnjë fe, apo popull, veçanërisht kur mungon mendja, mungon sheriatit dhe zë vend injoranca.

Por, e habitshme është ajo që shohim prej disa nga këta dijetarë dhe përpiqen me ngulm të duken me pamje kërkuese për pozita yjesh, edhe nëse kjo në kurriz të çfarëdo gjëje, me shpresë të qëndrojnë gjithmonë në rreshtat e parë ballorë të shoqërisë.

Çfarë të shohim, a mos disa dijetarë janë prishur shkencërisht dhe moralisht e kanë harruar rolin që kanë në përmirësimin e njerëzve dhe marrjen e tyre për dore drejt Krijuesit?

O dijetarë, ju nuk jeni yje Hollywood-i, apo yje futbollit, apo çfarëdo njeriu që dëshiron të bëjë aventura për të regjistruar emrin e tij në librin "Gines" në kurriz të vetëdijes së ymetit dhe fesë së tij.

A është ajo që dëgjojmë prej fjalëve, largimit të disave prej gjërave të paluajtshme në akide dhe moral, respektimit të tjetrit, pluralizmit të mendimeve, blasfemisë (qafirizimit) të myslimanit dhe mënjanimit nga bazat e sheriatit, gjë që mund ta kuptojmë?

A mund të imagjinohet kërkimi në brendësinë e librave dhe magazinat e opinioneve për mendime të çuditshme, që i refuzon truri dhe nuk është punuar me to në historinë e ymetit, e mëpastaj të hidhen në fytyrën e ymetit, duke shkaktuar tallje

ÇDO NJERIU I MERRET DHE I REFUZOHET FJALA, PËRVEÇ RESULLAHUT

O ju dijetarë: O trashëgimtarë të Pejgamberëve, bëhuni edukatorë, që ia bëjnë të dashur fenë njerëzve dhe nuk e urrejnë, afrojnë dhe nuk largojnë, jetojnë dhe nuk vrasin, e dinë kur flasin dhe kur heshtin.

përmes sugjerimeve dhe fjalëve, vetëm për t'u thënë: Unë ekzistoj?!

Qëkur është bërë shqetësimi i dijetarëve, kërkimi për pozita yjesh këtu e shfaqje atje, dhe numërim i muridëve (dashamirësve) e ndjekësve të tyre (sasi muridësh dhe ndjekësish)? A mendojnë këta, se njerëzit janë kope, që nuk mendojnë dhe nuk dinë dhe, nëse ata heshtin (nuk flasin), nuk do të thotë se ata janë të shurdhër (akhras)?

A ka mbërritur fesadi (prishja) tek këta të tillë, të punojnë për veten e tyre në një formë që të bën të qeshsh, përmes sugjerimeve dhe fjalëve që nuk respektojnë as të zotin e tyre dhe gjoja ata përfaqësojnë mendim në fenë e Allahut?

Nëse dijetari dëshiron të japë mendim në fenë e tij, atëherë le ta dimë mirë të gjithë se feja jonë nuk përmban mangësi, apo ajo nuk plotësohet, veçse me mendimin dhe shfaqjen e tij.

Dhe, le të ndalen gjithashtu disa nga praktikimi i ndërmjetësimit mes Allahut dhe mes njerëzve, sepse kjo nuk gjendet në akiden dhe fenë tonë dhe të mos i prezantojnë ligjërimet, sugjerimet dhe mendimet e tyre sikur ata janë Islami, që ato të zënë vendin e Librit të Allahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij (a.s), deri në atë gradë sa të ndjesh se nuk mund të arrish tek Allahu, veçse përmes tyre dhe nuk kupton rreth Allahut, veçse nëpërmjet tyre.

Mjaft më disa nga botimi i legendave dhe tregimeve, të cilat ua atribuojnë vetes, baballarëve dhe gjyshërve të tyre të vdekur, e çfarë përmbajnë prej kerameteve, mrekuillive dhe gjendjeve, që nuk mund të jenë, veçse për profetë.

Mos i befasoni njerëzit e thjeshtë, të cilët ju besojnë kur shohin pamjet e asketizmit dhe modestisë tek disa dhe përfytyrojnë me thjeshtësinë, apo me mendjelehtësinë e tyre, se

ky është argument i sinqeritetit dhe shenjë e besimit, pastaj zbulojnë se, ky i cili tund kokën, lëshon qepallat qetësisht dhe devotshmërisht ka luajtur mashtrimesh ndaj tyre, i ka humbur dhe ka shfrytëzuar tek ata ndjenjat më të larta, e ato janë, dashuria për fenë dhe bijtë e saj.

Mjaft më këta njerëz të thjeshtë dhe çfarë u prezantohet përpara tyre prej Islamit, deformimit të imazhit të tij me ekstremizma, qafirizma,

*A MUND TË IMAGJINOHET
KËRKIMI NË BRENDEËSINË
E LIBRAVE DHE MAGAZINAT
E OPINIONEVE PËR
MENDIME TË ÇUDITSHME,
QË I REFUZON TRURI
DHE NUK ËSHTË PUNUAR
ME TO NË HISTORINË
E YMETIT, E MËPASTAJ
TË HIDHEN NË FYTYRËN
E YMETIT, DUKE
SHKAKTUAR TALLJE PËRMES
SUGJERIMEVE DHE FJALËVE,
VETËM PËR TU THËNË:
UNË EKZISTOJ?*

bidatçizma dhe shturizma, e le të rikthejmë tek ata imazhin e Islamit të vërtetë, të pastër e të dëlirë.

O ju dijetarë: O trashëgimtarë të Pejgamberëve, bëhuni edukatorë, që ia bëjnë të dashur fenë njerëzve dhe nuk e urrejnë, afrojnë dhe nuk largojnë, jetojnë dhe nuk vrasin, e dinë kur flasin dhe kur heshtin.

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut, Krijuesit të gjithësisë. Atij, që me anë të mrekullive forcoi zemrën e të dërguarve të Tij, duke udhëzuar nëpërmjet tyre mendjet e hutuara dhe zemrat e devijuara nga drita e së vërtetës. Thotë në Kur'anin Famëlartë: "Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) deri në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona..."¹

Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta, ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës tonë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhamedit (a.s), që u dërgua mëshirë për të gjitha krijesat, plotësues i moralit dhe vulë e të dërguarve të Zotit. Thotë: "Shembulli im dhe i të dërguarve para meje është si shembulli i një burri që ndërtoi një shtëpi, të cilën e perfeksionoi dhe e zbukuroi, përveç vendit të një tulle, në një qoshe prej qosheve të saj. Njerëzit, që e vizitonin, i thonin: Pse nuk e vendos edhe këtë tullë?! Unë jam ajo tullë, unë jam vula e të dërguarve!"²

TË DASHUR DHE TË NDERUAR, MOTRA DHE VËLLEZËR,

Diku, në një qytet të quajtur Taif, një burrë i heshtur, që kishte kaluar pragun e të pesëdhjetave nga vitet

“U UDHËZOVE TI, U UDHËZUA YMMETI YT!”

e jetës së tij, me këmbë të gjakosura dhe me frymën e lodhur nga përballja me arrogancën e idhujtarisë dhe injorancën e mosdijes, u ul të pushonte nën hijen e ca pemëve...

Ishte i lodhur, i mërzitur. Çfarë nuk kishte kaluar mbi supet e tij në këto dhjetë vite... Por, zemra e tij rrihte mëshirë dhe falje, urtësi dhe dashamirësi të pakufijshme për krijesat e Zotit...

E, përtej lodhjes, mërzi, dhembjeve të trupit, që lëngonte goditjet e gurëve, sharjet dhe fyerjet e panumërta, i përqendruar në një qëllim dhe një pikësynim, me kokën e ulur dhe duart drejt qiellit, nisi të mermëriste këto fjalë: "All-llahumme, Ty po të ankohe për dobësinë time, për mungesën e rrugëve, për përçmimin nga njerëzit. O Mëshiruesi i mëshiruesve, Ti je Zoti i të dobësuarve, Ti je Zoti im! Në dorën e kujt po më lë?... Por, nëse Ti nuk je i zemëruar me mua, hiç nuk pyes..."³

Të dashur vëllezër muslimanë,

Herë pas here, në harkun e një viti kalendarik, na vijjnë ditë dhe data të shënuara, nëpërmjet të cilave ne përkujtojmë dhe mundohemi të nxjerrim mësim dhe mesazhe nga ndodhi dhe personazhe, ngjarje dhe mrekulli, që janë pjesë e Kur'anit dhe jetës së të dërguarve të All-llahut.

Si të thuash, vit pas viti, krejt natyrshëm, Zoti i gjithësisë na sjell në vëmendjen tonë ngjarje, prej atyre që na forcojnë besimin, që na japin kurajo dhe që na thërrasin për të mos u përkulur në jetë, përpara sprovave dhe vështirësive të saj.

E, pikërisht, mrekullia e Israsë dhe e Miraxhit, në kufijtë e një nate të begatë, është një ndalesë e rëndësishme, në të cilën jemi të ftuar të meditojmë thellë dhe të mbushemi me shpresë, optimizëm, krenari dhe vullnet sakrifice!

Pavarësisht faktit se "dijetarët e biografisë së Profetit (a.s), nuk kanë rënë dakort për datën e saktë të Israsë dhe Miraxhit, duke paraqitur transmetime dhe analiza rreth saj, por të gjithë ata janë në një mendje, se Israja dhe Miraxhi ishte një nderim dhe fisnikërim nga All-llahu i Madhëruar për të dërguarin e Tij..."⁴

Nga këtu, më lejoni të vendos para duarve tuaja, në një formë të përmbledhur, hadithin kryesor të kësaj ndodhie të mrekullueshme, që është koleksionuar në librin e saktë

*ISRAJA DHE MIRAXHI
ERDHËN SI PËRFORCIM I
HZ. MUHAMMEDIT (A.S)
NË RRUGËN E TIJ TË
MUNDIMSHME
TË THIRRJES,
NË EDUKIMIN E BREZAVE
ME DRITËN
E UDHËZIMIT HYJNOR
DHE BEGATITË E FESË
SË ALL-LLAHUT; ISLAMIT!*

të Imam Bukhariut dhe disa detaje nga transmetimi i Ibni Mesudit (r.a), për të parë mrekullinë e Zotit ndaj të Dashurit të Tij, Hz. Muhamedit (a.s).

Resulull-llahu (a.s) tregon: "Më sollën Burakun, një kafshë e bardhë, që hidhte hapin, ku i përfundonte vështrimi. Hipa në të, derisa mbërrita në Bejtul-Makdis... "Aty gjeti Hz. Ibrahimin, Hz. Musain, Hz. Isain dhe shumë të dërguar të tjerë,

3. Dr. Mervan Shejkhulerd, "Es-siretun-nebevijje", botimi i parë, Damask, 2003, vëll. 1, f. 268, duke u bazuar në historinë e Ibn Hishamit.

4. Muhammed El-Habesh, "Siretu Resulil-lah", botimi i 6-të, Damask, 1996, f. 101.

të cilëve u priu në namaz”⁵ Pastaj dola. Më erdhi Xhibrili (a.s) me dy enë; njëra me verë dhe tjetra me qumësht. Unë zgjodha qumështin. Xhibrili tha: “Zgjodhe natyrën e pastër! [U udhëzove ti, u udhëzua ymmeti yt!]⁶”

Pastaj nisëm miraxhin (lartësimin) drejt qiellit, ku Xhibrili trokiti... Na u hap dera dhe pashë Ademin (a.s), që më uroi mirëseardhjen dhe u lut për mua. Pastaj u ngjitëm në qiellin e dytë (dhe në çdo qiell, All-llahu e takonte me të dërguar të ndryshëm; në të dytin, me Isain, të birin e Merjemit dhe me Jahja, të birin e Zekerijasë, në të tretin me Jusufin, në të katërtin me Idrisin, në të pestin me Harunin dhe në të gjashtin me Musain).

Pastaj u ngjitëm në qiellin e shtatë, ku pashë Ibrahimin, që kishte mbështetur shpinën e tij tek Bejti Ma'muri, në të cilin hynin çdo ditë shtatëdhjetë mijë melekë dhe nuk dilnin më prej aty...⁷

VËLLEZËR BESIMTARË,

Në simbolikën e saj, ndodhia e Israsë dhe Miraxhit (detajet e së cilës janë të panumërta dhe është e pamundur të përfshihen në një hytbe të zakonshme), nëpërmjet dëshimit të saj në dy suret e zbritura në këtë përshpirtësi; sureja “El-Isra” dhe sureja “En-Nexhm”, dëshmon se “Muhammedi (a.s) është profeti i dy kibleve, imami i dy lindjeve dhe i dy perëndimeve,

5. Transmetimi i Ibn Mesudit (r.a), si te Ibn Hishami, “Es-siretun-nebevijje”, botimi i 4-t, Beirut, 1999, vëll. II, f. 30.

6. Transmetimi i Ibn Mesudit (r.a).

7. Transmetuar nga Imam Bukhari, nga Enes ibn Malik (r.a) dhe Malik ibn Sa'sa' (r.a).

trashëgimtari i të dërguarve para tij, prijësi i brezave pas tij! Pasi, në personalitetin e Hz. Muhammedit (a.s), mbrëmjen e Israsë, u takua Mekka me Kuds, Bejtul-Harami me Mesxhidi Aksanë. Aty, të dërguarit u falën pas tij, duke sinjalizuar kështu universalizmin e dërgesës së tij profetike, përjetësimin e imamatit të tij, humanizmin e mësimave të tij dhe përshtatshmërinë e tyre me gjithë ndryshimet e vendit dhe kohës”⁸

Israja dhe Miraxhi erdhën si përforsim i Hz. Muhammedit (a.s) në rrugën e tij të mundimshme të thirrjes, në edukimin e brezave me dritën e udhëzimit hyjnor dhe begatitë e fesë së All-llahut; ISLAMIT!

Atë natë, zemra e tij u mbush pafundësisht me dritën e pashuar të mbështetjes hyjnore, tamam si atë ditë, kur melekët i hapën gjoksin dhe ia mbushën me nurin e besimit dhe dashninë e Zotit!

Atë natë, iu dhurua amaneti më i shtrenjtë dhe garancia e përjetshme e lidhjes së qiellit me tokën dhe anasjelltas; namazi i pesë kohëve ditore!

Atë natë, u vulos mirësia dhe u derdhën bekime pafund për Pejgamberin tonë dhe ymmetin islam, deri në ditëne kiametit!

Atë natë, teksa kthehej me pesë namazet e ditës, si rrugë e pambyllur drejt kërkimit të mëshirës dhe Dritës së Zotit në jetën tonë, fjalët e Krijuesit, ishin ngulitur thellë në zemrën e tij (a.s), do ua thoshte më pas edhe sahabëve, mbarë botës: “O

8. Es-Sejiid Ebul-Hasen Ali El-Haseni En-Nedvi, “Es-siretun-nebevijje”, botimi i 12-të, Damask, 2004, f. 218-219.

Muhammed, këto janë pesë namaze, për çdo ditë dhe natë. Secili namaz do të shumëzohet me dhjetë, pra pesëdhjetë namaze...”⁹

TË DASHURIT E MI,

Në përfundim, më lejoni të kthehem, nga pikënisja e kësaj hytbeje. Atje nën hijen e pemëve, ku një burrë me fytyrë të dritshme, që as pluhuri, lodhja e mërzia, nuk ia largonin dot rrezatimin e bukurisë, me të cilën ishte gatuar krijimi i tij, lutej pa fund dhe priste...

Priste i bindur, në ato fjalë, që më pas do të përjetësoheshin në Kur'anin Famëlartë: “Zoti yt nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur!”¹⁰

Ai burrë i madh, që “një vit më parë, fëmijët e Taifit, qenë rreshtuar në të dy anët e rrugës dhe me gurë në duar, qëllonin këmbët e tij (a.s), teksa largohej prej aty për në vendin e vet.

Sot, pas një viti, po i rreshtoheshin Pejgamberët (a.s), atje në Kuds, me dhjetra të dërguar, të cilët po e prisnin me gëzim dhe donin të fale-shin pas tij...”¹¹

Ai burrë i madh, ajo zemër e pakufijshme, ajo dritë e pashuar, ai zë i përbotshëm, ajo thirrje për gjithësinë, ajo lutje dorëzimi... Hz. Muhammedi (a.s), udhëtari i papërsëritshëm i Israsë dhe Miraxhit...

(Hytbe e mbajtur në xhaminë “Ebu Bekër”)

Shkodër, më 15 maj 2015

9. Transmetuar nga Imam Bukhari, nga Enes ibn Malik (r.a) dhe Malik ibn Sa'sa' (r.a).

10. Kur'ani, Ed-Duha: 3.

11. Vehbi Sulejman Gavoçi, “Muhammedi alejhisselam – Jeta dhe vepra”, LOGOS-A, Shkup, 2011, f. 117.





Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Duke iu rikthyer një studimi...¹
Nuk e di pse një shkrim e kam krahasuar me një fotografi. E thënë me frazeologjinë popullore të gjyshërve tanë të shtrenjtë e të mirë: me një resme. Largësia e viteve, si shkrimin ashtu dhe fotografinë e bën të vyer, e bën kujtim, e bën arkivë, e bën ‘më të gjallë’, ‘më prekëse’, e bën dokument, shenjë jete, model krenarie, vlerë dhe gjurmë për t’u ndjekur nga gjeneratat e ardhshme. Kështu shkrimi-fotografi ‘flet’, e ndërkohë flet parreshtur edhe vetë Historia...

Këto motive e të tjera më shtyn teksa lexoja studimin: “Në gjurmët e dijetarit H. Vehbi Gavoçi – dijetari që nderon një komb, një ymet”, me autor Imam Muhamed Sytarin. Jo vetëm kaq, por sikur zbulova dhe, duken dukshëm, rrezëllitëse pas çdo rreshti e fraze ndjesia njerëzore e hyjnore, poetike marrëdhënia e shumëfishtë e autorit me protagonistin e këtij studimi, me H. Vehbi Gavoçi. (Kjo marrëdhënie merr dimensione të tjera, kur kujtojmë se dijetari Gavoçi është larguar nga kjo botë: si një gur i çmueshëm që i dha dritë diturie e mirësie këtij ymeti.)

Me shumë kujdes e me dashurinë e një nxënësi për Mësuesin e tij të ndritur, autori Sytari përmes fakteve

1. Sytari, Muhamed: Nun Pasha Lapsin... (Shënime vetjake nga periudha e drejtimit të Myftinisë Shkodër, prill 2010 – prill 2013; Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Myftinia Shkodër; Shkodër, 2013. Nga rubrika: ‘Studime’ e këtij libri, në optikën time të shqyrtimit është shkrimi: “Në gjurmët e dijetarit H. Vehbi Sulejman Gavoçi – dijetari që nderon një komb, një ymet”, f. 118 – 125, Shkodër, 09.03.2012.

DUKE IU RIKTHYER NJË STUDIMI...

-optikë shqyrtimi-

interesante, rrëfen jetën e dijetarit, të cilën e ‘përkthen’ në gjurmë. Një gjurmë të pashlyer, një gjurmë në udhëtim, një gjurmë që të nderon, që bashkëbisedon e të frymëzon...

Në këtë rrugëtim të veprës dhe misionit të H. Vehbisë, ndalemi dhe shënojmë plot fjalë që i ka mbledhur autori Sytari si margaritarë: a) fjalën-devizë të kryemyftiut të Sirisë Dr. Ahmed Keftaro: “...sepse dijetari punëtor (nënkupto: Haxhi Vehbinë)



SHEJKH VEHBI S. GAVOÇI

është shembull në këtë kohë që fjalët janë shtuar dhe punët janë pakësuar.”, b) Hoxha ynë ka lindur në Shkodër dhe është brumosur me besimin, kulturën dhe qytetarinë e të atit, që për të thoshte: “Kurrë nuk ka treguar se ka nevojë për dikë. Ndoshta e ka ngrënë bukën thatë, ka punuar si punëtorët, mirëpo s’e ka ulur kokën para kujt. ... Kemi mësuar prej tij (babës, - shënimi im Xh. B.) me qenë të saktë! Nuk e di se baba i jonë na ka gënjyer ndonjëherë, ose ka gënjyer dikë, ose dikush po thotë se po gënjen.”, c) I një skene respekti e nderimi, kur Dijetari islam, Shejkh Beshir El-Bani (teksa i puthte dorën i thoshte: “Ti je Hoxha dhe Mësuesi ynë”!), d) Nuk e harroi asnjëherë vendin e tij (Shkodrën e Shqipërinë, - nënvizim

im, Xh. B.), ku dhe dëshmohet: “Sa herë që mblidhemi me të, e diskutojmë për gjëndjen në Shqipëri pas 1997, Profesori vetëm qan për atë gjendje të keqe të vendi tonë...”!, dh) H. Vehbi Sulejman Gavoçi është “Qytetar Nderi” i Shkodrës., e) Letrat e vlefshme e dritëdhënëse që Dijetari i aka dërguar Muhamed Sytarit, ku në mes të tjerave e porositi: “Dijeni mirë se ju po mësoheni për t’u bërë trashëgimtarët e Profetit (a.s.), domethënë., po punoni për një gradë më të lartë se çdo gradë e leximeve të tjera. E mira për ju është e pa përkufizuar.”

Unë përmenda vetëm disa ‘grimca’ të këtij studimi, në optikën time shqyrtuese, sepse çdo fjalë e Hoxhës është një ixhazet, një dekalog, një mesazh me vlerë, aq më shumë për kohën tonë, që peizazhi i jetës sonë, e përditshmja e saj ende është e turbullt dhe me kontraste ngjyrash herë varfëruese e herë optimiste. Ndaj dhe ‘trokita’ në dyert e Hoxhës së ditur për të risjellë jetën, fjalën dhe gjurmën e tij, të cilat i gjeta të rrëfyera bukur e në mënyrë bindëse nga Imam Muhamed Sytari në studimin e tij: “Në gjurmët e dijetarit H. Vehbi Sulejman Gavoçi – dijetari që nderon një komb, një ymet”.

Jo më kot autori Muhamed Sytari i ka dhënë shkrimit të tij (si fillim parathënie e më vonë si monografi) një vizion të tillë: “Hoxha i jonë do të vazhdojë të jetë përherë në mesin tonë, në një rresht letre, në një faqe libri, në një hap medrezeje, në një mur xhamie, në një minare prej ku ezani i teuhidit rrezaton mirësi hyjnore mbi Shkodër, mbi Shqipëri...”

Shkodër, maj, 2015



Hfz. Mehas Alija

Imam, xhamia "El-Hidaje", Zvicër

Falënderimet dhe lëvdatat më të mëdha janë për Allahun e Madhëruar, Zotin dhe Krijuesin e të gjitha botëve. Selami dhe përshëndetjet tona qofshin edhe për të Dërguarin e Allahut, Muhammedin Alejhisselam, mbi familjen e tij të madhe, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që jetuan me të vërtetën në zemër.

“Me të vërtetë, ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu dhe pastaj janë të përqëndruar në të, atyre do t’ju zbresin melaqe dhe do t’u thonë: Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni. Dhe gëzojuni xhennetit që u është premtuar. Ne jemi miqtë tuaj në këtë botë dhe në botën tjetër. Ju (në xhennet) do të keni çfarë të dëshironi dhe të çfarë të kërkonin, si gosti prej atij që falë shumë dhe që është mëshirues.” - (Fussilet, 30-32).

XHEMAT I RESPEKTUAR,

Në ajetin që sapo e lexuam, kuptuam se nuk mjafton vetëm besimi në Allahun e Madhëruar, porse duhet përqëndruar në fënë e Tij. Istikame nuk donë të thotë vetëm të thuash “besova Allahun”, e pastaj të mos i ndjekësh mësimet dhe dispozitat e Tij të larta. “Besova Allahun”, do të thotë: “u dorëzova dhe pranova”. Të pranosh dhe pastaj të veprosh me maturi në rrugën që Zoti e ka caktuar për njerëzit, është vija që e tërhoqi Muhammedi (a.s), dhe që e ndoqën njerëzit më të ndritur të ymetit tonë.

Në një hadith, Muhammedi (a.s), thotë: “Përqëndrohuni sa të jetë e mundur në Rrugën e Allahut, dhe mundohuni që sa më afër këtij qëllimi të jeni.” - (Buhari dhe Muslimi). Përkushtimi i plotë në fé

RUAJE FENË E ALLAHUT QË ALLAHU TË TË RUAJ TY!

mund të ndodh vetëm atëherë kur fjalët, veprat dhe qëllimet tona të jenë të orientuara nga kënaqësia e Allahut të Madhëruar. Zoti nuk ka kërkuar nga njeriu që ai të bëjë të pamundurën, por ka kërkuar që ai, sa të ketë mundësi, të përqëndrohet në Rrugën e drejtë, e nëse nuk ka mundësi të jetë origjinal në arritjen e këtij qëllimi, të paktën të sakrifikojë dhe të mundohet të jetë sa më pranë caktuarit të synuar. Kjo i ngjan rastit kur dikush hedh shtizën për të goditur cakun, edhe pse ai nuk ka mundësi çdo herë ta godasë qendrën, ai përsëri qëndron dhe shenjon afër saj.

Është e bukur rruga e besimit, kur ajo është mesatare. Rrugë pa ekstremitete. Kjo ndjekje e rrugës së Zotit nuk e nënçmon aspak njeriun, e as që e bën ta teprojë në praktikimin e saj, ashtu që nafilët (veprat vullnetare) t’i ngris në derexhen e farzeve (obligimeve), kurse mekruhet (veprat e urryera) t’i konsiderojë si harame (vepra të ndaluara). Istikameja, ose qëndrueshmëria në fé, nuk është që ta kufizosh veten dhe të ndalohesh nga gjërat e bukura dhe të mira që i ka lejuar Allahu i Madhëruar.

Transmetohet nga Enesi (r.a) i cili thotë: “Tre njerëz prej të afërmeve erdhën në shtëpitë e grave të Pejgamberit (a.s). dhe pyetën për ibadetin e Pejgamberit (a.s). - e pasi morën përgjigje, atyre iu duk se vepra e tyre është e pakët dhe thanë: “Ku jemi ne e ku është Pejgamberi (a.s). Allahu atij ia ka falur të gjitha mëkatet e mëparshme dhe ato të ardhshmet”. Njëri prej tyre tha: “Sa më përket mua, unë gjithnjë tërë natën do të falem”. I dyti tha: “Unë vazhdimisht do të agjëroj”. I treti tha: “Unë do të izolohehem prej grave dhe kurrë nuk do të martohem”. Kur vjen i Dërguari i Allahut (a.s). u thotë: “A jeni ju që keni thënë këtë dhe këtë? Sa më përket mua, pasha Allahun, unë jam më i kujdesshëm dhe më i devotshëm ndaj Allahut se sa ju, por unë agjëroj dhe ha, falem dhe flej, dhe bëj jetë

bashkëshortore! Kush largohet nga Sunneti im, ai nuk më përket mua”. (Muttefékun alejhi).

Për të qëndruar pa luhatshtëm në Rrugën e Zotit nevojitet një durim i madh, përpjekje e vazhdueshme, vetëkontrollë, përmbajtje ndaj ligjeve të Allahut, si dhe ndjekje me dashuri dhe respekt të sunetit të Muhammedit (a.s).

Në një hadith tjetër Muhammedi (a.s), thotë: “Zoti ka sjellë si shembull një rrugë të drejtë. Në të dyja anët e rrugës, ndodhen dy mure. Në çdo mur, ndodhen dyer të hapura, të mbuluara me perde joshëse. Në krye të rrugës së drejtë, ndodhet një ftues që i fton njerëzit t’i përmbahen vetëm rrugës së drejtë. Ai u thotë njerëzve: “O njerëz! Ndiqni këtë rrugë dhe mos devijoni!” Nëse dikush turret të hapë një perde, një ftues në mes të rrugës i thërret: “Të mjerët ju! Mos i hapni perdet! Nëse do t’i hapni, do të hyni brenda dhe do të rrëshqisni!” Më pas, duke komentuar hadithin, Pejgamberi (a.s) thotë: “Rrugë e lartpërmendur, është Islami. Dy muret anësore janë ndalesat e Zotit. Dyert janë dyert e haramit. Perdet e bukura mbi dyer, janë zbukurimet e shejtanit. Nëse do të hyni në ato dyer, do të bini në xhehenem. Ftuesi që ndodhet në krye të rrugës është Kur’ani Famëlartë. Ftuesi që ndodhet në mes të rrugës, është ndërgjegjja e pastër që Zoti e ka vendosur te çdo njeri.”

Vëlla dhe motër e nderuar, ruaje fënë e Allahut që Ai të të ruaj ty dhe familjen tënde. Ndiqe rrugën e Islamit dhe mos hap perdet e haramit, sepse pas atyre perdeve janë dyert e xhehenemit. Shansin që e kemi sot, shumëkush nuk e ka, andaj le t’i shfrytëzojmë këto tre muaj dhe le të përqëndrohemi edhe më tepër në Rrugën e Zotit dhe rreth mësimëve të saj.

*(Hytbeja e xhumasë,
mbajtur në xhaminë "El-Hidaje"
në St. Gallen të Zvicrës,
më 24.4.2015)*



Sheikh Vehbi S. Gavoçi

Hz. Umeri qe njeriu i parë që i dha besën Ebu Bekrit si kalif mbas Profetit (a.s), mandej dhanë besën ata që u ndodhën në atë mbledhje.

Më vonë u tubuan shumë njerëz në xhami të Profetit (a.s), të cilët i dhanë besën Ebu Bekrit si kalif e se do të zbatonin urdhrat e tij.

Qysh në fillim hz. Umeri, sikur hz. Osmani e hz. Aliu u bë dora e djathtë e kalifatit.

Brenda dy vjetëve që qëndroi Ebu Bekri kalif, hz. Umeri nuk iu largua asnjë ditë atij.

Kur u sëmur rëndë Ebu Bekri dhe ishte në prag të vdekjes, pyeste secilin që e vizitonte: Çka thoni për të lënë mbas tij hz. Umerin si kalif? Të gjithë e pëlqenin atë propozim, e kështu u emërua kalif më 22 Xhumadun.

Menjëherë emëroi hz. Aliun si gjykatës dhe Abdull-llahun, djalin e Mes'udit, për financë, po ashtu emëroi edhe Zejdin etj, të cilëve u caktoi rroga të përshtatshme.

CAKTIMI I RREGULLIT TË KALENDARIT

I erdhi hz. Umerit një letër me datë të muajit Shaban. Umeri pyeti: Shaban i cilit vit? Vitit që ka kaluar apo të atij që vjen?

Pastaj thirri disa sahabe të mëdhenj e u tha: Bëni një kalendar, që ta njohin njerëzit e të punojnë me të.

Dikush tha: Përdorni kalendarin e romakëve, atë gregorian që përdoret deri sot.

Të tjerë dhanë mendime të ndryshme;

Jo, ai është i gjatë.

UMERI NË KALIFATIN E SHOKUT TË VET, EBU BEKR

Të përdorim kalendarin persian. Le të fillojmë me datën e Dhulkarnejnit.

Në fund, nga të pranishmit u vendos të vihet në përdorim kalendarit Islam, i cili fillon me emigrimin e Profetit (a.s). U caktua muaji Muharrem si muaji i parë i vitit, se në atë muaj fillon emigrimi i sahabeve.

E ashtu u bë. U zbatua propozimi i hz. Aliut, i cili u pëlqye nga këshilli e u caktua muaji Muharrem si muaji i parë i vitit, e viti i parë në regjistrim, viti i emigrimit. Ky kalendar përdoret sot në jetën e muslimanëve e të disa qeverive të tyre. Pra, kështu thuhet p.sh se Profeti (a.s) vdiq në fillim të vitit të njëmbëdhjetë të emigrimit.

VENDOSJA E TITULLIT KALIF

Hz. Umeri kërkonte të vendoste një zëvendës të tij në Irak. Për këtë mendoi të dërgonte dy njerëz të njohur e të mençur që të merrnin të dhëna për Irakun, për njerëzit, gjendjen e vendit, të ardhurat e tij. Këta u paraqitën për të hyrë te hz. Umeri, në pritje për të marrë udhëzimet e duhura. Ata i thanë Amrit, djalit të

Asit, që t'i lejonin të hynin në pritje te i pari i muslimanëve. Amri hyri te hz. Umeri dhe e përshëndeti atë si i pari i muslimanëve. Hz. Umeri e pyeti Amrin se ku e gjeti atë llagap. Ai shpjegoi se këtë e mësoi nga dy djemtë që kërkonin të hynin në pritje. Amri pohoi se ata të dy kanë gjetur llagap të përshtatshëm, duke arsyetuar para hz. Umerit: Ti je i pari i muslimanëve e ne jemi besimtarë.

Qysh atë ditë çdo sundimtar u quajt "Kalif", kështu u vazhdua edhe në të ardhmen.

LIDHJA E RROGËS FOSHNJËS POSA LIND

Abdull-llahi, djali i Eufit, ka treguar: Një grup shtegtarësh erdhi në Medinë dhe u vendosën në disa çadra jashtë këtij qyteti. Kur e mësoi hz. Umeri këtë gjë, i tha shokut të vet, Abdurrahmanit: Do të ishte mirë që ne të dy të shkojmë e të kalojmë natën afër atij karvani, që mos t'i shqetësojë ose t'i vjedhë kush shtegtarët.

Propozimi u pëlqye. Të dy shkuan afër atyre çadrave. Në kohën e duhur filluan të falen. Hz. Umeri gjatë të falurit dëgjoi një zë foshnjeje që qante. Kjo u përsërit disa herë.

Nga mëngjesi hz. Umeri shkoi afër asaj çadre të qortojë nënën që flinte e nuk interesohet për të voglin, por e linte të qante.

E ëma sqaroi që fëmija qante, pse ajo ia kishte prerë qumështin para tri ditësh. Hz. Umeri i tha se nuk duhet t'u pritët qumështi të vegjëlve, mbasi kanë nevojë për të .

Në mëngjes u ul në Medinë, fali sabahin si imam (prijës), qau në të falur e mbas kryerjes së kësaj detyre tha: Hej muslimanë, mos u ndani gjirin fëmijëve, se ne u caktojmë atyre rrogë qysh sa të lindin. Kjo fjalë u bë ligj e u përhap me anë të shtetit musliman në rregullat botërore.

Sot veç babai që është nëpunës zyrtar ka njëfarë rroge për fëmijën,

*HEJ MUSLIMANË,
MOS U NDANI GJIRIN
FËMIJËVE, SE NE
U CAKTOJMË
ATYRE RROGË
QYSH SA TË LINDIN.
KJO FJALË U BË LIGJ
E U PËRHAP ME ANË TË
SHTETIT MUSLIMAN
NË RREGULLAT
BOTËRORE.*



por jo tregtari i vogël, pemëshitësi, punëtori privat e bujku i lodhur.

Ky humanizëm Islam është për t'u admiruar.

BURRË I MENÇUR

Lejthi kallëzon se i sollën hz. Umerit një djalë të ri, të mbytur e të hedhur në anë të një rruge. Hz. Umeri pyeti shumë me policinë e njerëzit e vet, por më kot, nuk doli asgjë. Atëherë u lut duke thënë: Hej Zot, më bashko me mbytësin e atij djali.

Mbas gati një viti u gjend një foshnje e vogël po në vend të atij djali të ri.

Kur u mësua kjo, hz. Umeri tha: Inshallah, tani po marrim gjakun e djalit të mbytur vjet.

Hz. Umeri ia dha atë foshnjë një gruajë pa fëmijë, së cilës i pagoi rrogë, që të interesohej për të dhe e porositi duke i thënë se, nëse vjen kush për ta kërkuar atë foshnje, menjëherë ta njoftonte atë.

Foshnja u rrit te gruaja që e mbante e kujdesej për të. Më vonë erdhi te ajo një vajzë e vogël e i thotë asaj gruajë: Zonja ime dëshiron për të parë foshnjën që ke ti, mandej ta kthej përsëri. Gruaja pranoi, bile e çoi vetë tek ajo zonjë. Kur hyri ajo në atë shtëpi, pau një vajzë që mori fëmijën, e përqafoi dhe e puthi, mandej ia dha gras.

Gruaja u kthye me djalë në shtëpi. Shpejt lajmëroi hz. Umerin për ngjarjen dhe i tregoi shtëpinë, ku e çoi atë foshnje.

Hz. Umeri u bë gati me shpatë të fshehur e shkoi te shtëpia e duhur.

Para asaj shtëpie po rrinte një plak prej një familjeje të madhe, me

emër të mirë. Hz. Umeri u ndal te plaku, e pyeti për gjendjen, mos ka ndonjë kërkesë o ankesë dhe në fund e pyeti si e ka vajzën e vet.

Plaku u përgjigj: Vajza është mirë, falet, agjëron e lutet rregullisht.

Hz. Umeri i tha se dëshironte të rrinte pak me të. Plaku njoftoi për këtë familjen. Mbas pak u kthye e i tha hz. Umerit se mori leje e mund të hynte në shtëpi. Kur hyri hz. Umeri në dhomën ku ishte vajza e kërkuar gjeti atje disa fëmijë, por kërkoi që ata të dilnin jashtë nga dhoma. Hz. Umeri mbeti vetëm me vajzën. Nxori shpatën e fshehur e u betua para saj, se po nuk tregoi të drejtën, (të vërtetën) do ta mbyste.

Vajza u përgjigj: Hej i pari i besimtarëve, mbasi arriti puna këtu, të betohem se po të tregoj të vërtetën. Kemi pasur një plakë të vobektë, që rrinte me ne e na shërbente, e desha shumë atë. Një ditë më tha: -Hej vajza ime, dua të shkoj në një vend për disa ditë e për mos të të lënë vetëm, po bie vajzën time në vendin tim që t'u shërbejë e të sillet me ju si unë.

Erdhi ajo "vajzë". Edhe unë si vajzë nuk u ruajta për të mos më parë trupin, mbasi ishte vajzë si unë.

Një natë, posa rashë në gjumë, më erdhi ajo "vajzë" që në fakt ishte djalë e më mori nderin. Unë menjëherë me një thikë që kisha pranë shtratit, e thera, derisa vdiq.

Lava gjakun, mora kufomën dhe e çova në vendin, ku e gjetët ju. Mirëpo prej atij djali, pa dëshirën time, u bëra shtatzënë.

Kur linda fëminë, e fsheha nga familja, mandej e vendosa, ku gjetët më përpara kufomën e atij njeriu.

Hz. Umeri u kënaq nga nderi e burrëria e saj, e diti që ajo mbyti sulmuesin në mbrojtje të nderit të vet.

Doli nga dhoma ku qe vajza si dhe nga shtëpia. Kur takoi plakun, ia lavdëroi vajzën e tij të mirë e besimtare.

Plaku falënderoi hz. Umerin: Zoti të dhashtë të mira, se interesohesh për popullin tënd.



"Në shoqëritë
tona, të zhytura
në dështim,
një fjalë
trupëzohet,
për të thënë:
Ah, sikur
njerëzit
të qeshnin
në fytyrën
e njëri-tjetrit,
siç e përqeshin
njëri-tjetrin"

Dr. Salahudin Kajtaro

NJË DITË

TE XHAMIA E KAL



E BUKUR LASË "ROZAFÄ"...



DIVERSITETI FETAR E KULTUROR DHE PAQJA SOCIALE

Ditëve të fundit, në horizontet tona, sa vjen e po shtohen thirrjet e islamofobisë, në djepin e artikullshkruesve dhe komentuesve më të këqinj të mundshëm, që përveç vrerit që vjellin, servilizmin ndaj të keqes dhe shembullin e miopësisë intelektuale, dëshmojnë edhe si një model jo i shëndetshëm për t'u pasuar nga një brez, që më shumë se kurrë sot ka nevojë për mësimet dhe udhëzimet e fesë.

Fatkeqësisht, nxitjet perëndimore

A ËSHTË KJO HISTERI KOLEKTIVE E KËTIJ MODELI, FATURA QË NE MUSLIMANËT DUHET TË PAGUAJMË, PAS DËSHMIMIT TONË SI THIRRËS DREJT VLERAVE TË HARMONISË DHE TOLERANCËS NDËRFETARE NË BOTË?

të poshtërimit fetar, mosrespektimit të shenjtërive të tjetrit dhe të bërit "art" me absurditete qesharake (si rasti i ekspozitës së fundit në Teksas), që fyejnë intelektin dhe ndjenjat e miliarda muslimanëve në mbarë globin dhe shtojnë dozat e urrejtjes ndërfetare nëpër botë, nuk është gjë tjetër vetëm se dëshmi e dekadencës morale, intelektuale dhe shpirtërore, që kanë prodhuar sistemet e dobëta njerëzore, sot në botë.

Me fjalë të tjera, islamofobia në rritje, që përkthen edhe në praktikë thirrjet e të shkuarve të afërt për luftë të hapur ndaj Islamit dhe vlerave të tij, pa asnjë justifikim logjik, po kthehet në një shtysë më tepër, që na bën të bindemi përherë e më shumë,

se ky shekull është shekulli i Islamit!

Një pyetje lind vetvetiu, teksa shoh eksitim të thirrësve të radikalizmit racist në Evropë dhe atyre amerikanë, që në emër të lirive ekstreme, nxisin urrejtje dhe dhunë krejtësisht të pajustificueshme fetare në botë: A është kjo histeri kolektive e këtij modeli, fatura që ne muslimanët duhet të paguajmë, pas dëshimit tonë si thirrës drejt vlerave të harmonisë dhe tolerancës ndërfetare në botë?

A është kjo fatura e mosmirënjohjes, që perëndimi i shpreh sot muslimanëve, pas shekujve dritë e qytetërim, në të cilët muslimanët i mësuan paraardhësve të këtij modeli njerëzish të sëmure, pastrimin dhe pastërtinë, moralin dhe ruajtjen e nderit, dijen dhe pastrimin nga analfabetizmi dhe injoranca, gjuhët e huaja dhe shkencat e panumërta, tolerancën dhe vlerësimin e qenies NJERI dhe aftësinë e të jetuarit në paqe me tjetrin?

E teksa Kur'ani pyet: "A nuk është shpërblimi i mirënjohjes, veçse mirënjohja?", realitetet e sotme bëhen dëshmitare të heshtura të një devijimi nga nivelet e larta të qytetërimeve hyjnore, ku njeriu është vëlla i njeriut dhe ku, shenjtëria e tjetrit është kufi respekti, që nuk duhet shkelur as tejkaluar; me rrobë fetare, intelektuale, politike a kulturore qoftë! Sepse diversiteti fetar e kulturor, duhet të nxisë përherë e më shumë paqe sociale, jo ekstremizëm laik, nxitës urrejtje e islamofobie, që i ngjan një kanceri të dëmshëm, me të cilin duhet të përballemi pa ndrojtje, me qetësi dhe me të gjitha mënyrat legjitime!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, 5 maj 2015



“Për Allahun
nuk thuhet:
kur dhe ku...
Sepse Ai është,
i Cili krijoi
"kur" dhe "ku"...
Ai është,
i Cili krijoi
kohën dhe vendin,
e nuk varet
prej tyre,
siç ne varemi...”

Dr. Mustafa Mahmud

HIDHEN THEMELET E XHAMISË SË NAMAZGJASË



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, më 13 maj 2015 ka hedhur zyrtarisht themelet e Xhamisë së Namazgjasë në Tiranë, në prani të Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani, Presidenti i Republikës së Turqisë z. Rexhep Tajip Erdogan, dhe personalitete të tjera nga Shqipëria dhe Turqia.

Në fjalën e tij Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani falënderoi popullin turk për ndihmën dhe përkrahjen e tyre për ndërtimin e kësaj xhamie. Presidenti Nishani ndër të tjera tha: “Ne sot ndodhemi në një vend të bekuar, ku që prej themelimit të Tiranës, 400 vjet më parë, e deri në ditën e errët, kur diktatori komunist Enver Hoxha i penalizoi shqiptarët me dhunë nga e drejta e besimit, qindra dhe mijëra besimtarë myslimanë shqiptarë faleshin këtu në këtë shesh, për hir të Zotit. Këtu në këtë vend shqiptarët i drejtoheshin Zotit madje edhe në heshtje edhe në ditët e egra të sulmit komunist ndaj kulteve fetare. Jam shumë i lumtur që sot hedhim themelet e kësaj xhamie, shtëpisë së Zotit për besimtarët myslimanët të vendit tim.”

Presidenti Nishani vuri theksin gjithashtu edhe mbi harmoninë ndërfaqetare, si një model perfekt jo vetëm gjatë ditëve të bukura të historisë sonë, por edhe në momentet më të vështira, kur klerikët ishin së bashku në burgjet dhe kampet e internimit të regjimit.

Një fjalë përshëndetëse mbajti edhe presidenti i Turqisë z. Rexhep Tajip Erdogan, i cili ndodhet në Shqipëri në një vizitë zyrtare me ftesë të Presidentit të Republikës.

“Kjo xhami do të ndërtohet me kontributin dhe ndihmat e popullit turk. Afërsia e kësaj xhamie me kishën, dhe prania e muzeut të bashkëjetesës, i cili do të ndërtohet pranë kësaj xhamie, tregon diversitetin dhe harmoninë në Shqipëri.”, nënvizoi presidenti Erdogan.

Ai foli gjithashtu për lidhjet historike midis dy popujve për personalitete të përbashkëta shqiptare siç kanë qenë arkitekti i xhamisë Sulltan Ahmet, Sami Frashëri, autori i himnit kombëtar turk Mehmet Akif Ersoj, 35 sadrazamë (kryeministra) në kohën e Perandorisë Osmane, si dhe kontributin e miliona shqiptarëve që banojnë në Turqi.

Pas fjalës së dy presidentëve, kryetari i Komunitetit Mysliman të

Shqipërisë z. Skender Bruçaj ka bërë një lutje (duá), ku ndër të tjera tha: “Po lutemi sot të mbledhur në një ditë të veçantë, në vendin e bekuar të Namazgjasë, për të filluar realizimin e ëndrrës shumë vjeçare të besimtarëve myslimanë të Tiranës dhe mbarë besimtarëve shqiptarë.

O Allah i Madhëruar! Begatoje këtë vend të shenjtë, nga begatia jote e pafundme, bëje një vend ku lartësohet dhe nderohet emri Yt i Madhëruar me adhurime të sinqerta! Bëje një vend ku shpërndahet dashuria, dija dhe respekti për të gjithë.”

Pas kreut të KMSH-së një lutje ka mbajtur edhe kreu i Komunitetit Mysliman të Turqisë, z. Mehmet Gormez, i cili ishte i pranishëm në hedhjen e themeleve të Kompleksit të Namazgjasë.

Më pas është shtypur butoni për hedhjen e betonit, ku ka nisur zyrtarisht edhe puna për ndërtimin e Xhamisë dhe Kompleksit të Namazgjasë.

Ky kompleks do të jetë qendra më e madhe Islame në Ballkan, e cila do të përfshijë xhaminë, një sallë konferencash, sallë mbledhjeje, një sallë ekspozitash, Muzeun e parë Islam në Ballkan, bibliotekën, zyra, parking, si dhe hapësira të tjera për publikun.

Kompleksi Namazgja do të ketë një kapacitet të përgjithshëm prej 20.000 metrash katrorë, kurse xhamia do të ketë një kapacitet prej 5.000 vetash, që mund të falen në të njëjtën kohë.

Në ceremoninë e hedhjes së themeleve të xhamisë së Madhe të Tiranës morën pjesë një numër i madh qytetarësh të kryeqytetit dhe më gjerë.

(marrë nga: www.kmsh.al)



U PËRKUJTUA 160 VJETORI I LINDJES SË H. ALI ULQINAKUT

Ditën e shtunë, më 25 prill 2015, Bashkësia Islame e Ulqinit zhvilloi një simpozum në përkujtim të 160 vjetorit të lindjes së dijetarit të shquar Hafiz Ali Ulqinaku.

Në këtë simpozum referuan studiues të ndryshëm nga Ulqini, Podgorica, Lezha, Shkodra e Prishtina, të cilët nxorën në pah vlerat e mëdha diturore të H. Ali Ulqinakut, si një dijetar i urtë, prijës drejt vlerave islame dhe harmonisë kombëtare.

U fol për vlerën e abetares dhe fjalorëve të tij, pa përmendur kryeveprën që e bëri të njohur gjithandej H. Ali Ulqinakun, Mevludi Sherifi, përkthimi me përshtatje nga osmanishtja, si një vepër e trashëguar brez pas brezi ndër shqiptarë etj.

Në dy seancat e këtij simpoziumi referuan: Mr. Ali Bardhi, “Hafiz Ali Ulqinaku në dokumentat e Arkivit Osman të Kryeministrisë në Stamboll”, Imam Muhamed Sytari, “Thirrja Islame në Mevludin e H. Ali Ulqinakut – krahasime me vargjet e Hafiz Jusuf Këlmendit dhe Sheh Ahmed Shkodrës”,



Mark Vuji, “Vlerat e sistemit të punës së Hafiz Ali Ulqinakut në fushën e përkthimeve dhe të studimeve gjuhësore”, Dr. Maksut Haxhibrahimi, “Jeta dhe vepra e Hafiz Ali Ulqinakut”, Arben Halluni, “Shkodra në nderim të dijetarëve”, Ali Lunji, “Jeta dhe vepra e Hafiz Ali Ulqinakut”, Dr. Nail Draga, “Ulqini në kohën e Hafiz Ali Ulqinakut, qspekte socio-demagrofike”, Nusret Cenaj, “Vlera edukative e Mevludit të Hafiz Ali Ulqinakut”, Omer Kajoshaj, “Hafiz Ali Ulqinaku në ditët tona”

dhe Ismet Karamanaga, “Hafiz Ali Riza Ulqinaku, figurë me përmasa kombëtare”.

Në përfundim të referatit të tij, Myftiu i Shkodrës i dhuroi Kryeimamit të Ulqinit, Ali ef. Bardhi një gjurmë të kaligrafisë dhe vulës së H. Ali Ulqinakut.

Ndërkohë, në emër të organizatorëve, iu propozua komunës së Ulqinit që Qendra Kulturore e këtij qytetit të mbajë emrin e dijetarit të madh Hafiz Ali Ulqinaku.

“PROFETI MUHAMED (A.S) – SHEMBULLI MË I BUKUR”

Përfaqësuese të Zyrës së Gruas në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, më 29 prill 2015, zhvilluan një takim me gratë besimtare të Shkodrës, ku u fol mbi jetën dhe shembullin e Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi të.

Përgjegjësja e Zyrës së Gruas në KMSH, zj. Fatma Karaj theksoi se profeti Muhamed, ishte dhe është mëshirë për botët.

“Ajetet kur’anore e përshkruajnë atë si mëshirë për botët. Kjo siguriqet që është një dhunti, një mirësi dhe urtësi, por në të njëjtën kohë është dhe një përgjegjësi të cilën Profeti Muhamed ((a.s)) e përfaqësoi në mënyrën më të bukur, duke u bërë shembulli më i shkëlqyer, ku njerëzimi të frymëzohet, të motivohet, si dhe të referohet për të mirën, të drejtën dhe virtytet.” tha ajo.

Ndërsa përfaqësuesja tjetër e kësaj Zyre, Nadia Lika, nënvizoi faktin se në tërë jetën e Profetit Muhamed (a.s), ai zgjodhi dhe jetoj rrugën e mesme.



“Në gjithçka ai ishte në rrugën e mesme, ai kurrë nuk ishte dhe nuk bëri pjesë në as një ekstrem, por zgjodhi, jetoj dhe këshilloi rrugën e mesme. Padyshim që në çdo punë e mesmja është zgjidhja më e mirë. Ne si myslimane më shumë se kushdo tjetër duhet të jemi në këtë rrugë, duke ndjekur shembullin e më të përkryerit të njerëzimit, Profetit Muhamed, paqja

qoftë mbi të”, tha znjsh. Lika

Takimi i cili u zhvillua në ambientet e xhamisë së Parrucës, u hap me leximin e disa ajeteve nga Kur’anit Famëlartë nga përfaqësuesja e kësaj zyre, Ana Haxhiu. Gjatë kësaj vizite përfaqësueset e Zyrës së Gruas kanë zhvilluar edhe një takim në Medresenë e Shkodrës si dhe Xhaminë e Ebu Bekrit.

(marrë nga: www.kmsh.al)

MALËSIA E MADHE, INAUGUROHET XHAMIA NË KULLAJ

Ditën e enjte, më 30 prill 2015, Myftinia e Malësisë së Madhe ka organizuar ceremoninë e inaugurimit të xhamisë më të re në zonën e Shkodrës, atë në fshatin Kullaj (Gruemirë).

Ceremonia nisi me këndimin e një pjese kur'anore, pas së cilës teologu Agim Elezi bëri një pasqyrë të historisë së fillimit të punimeve dhe kontribuuesit e kësaj xhamie, që u ndërtua nën mbikëqyrjen e Myftinisë së Malësisë së Madhe.

Më pas, në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë ditë të gëzueshme, si dhe bëri thirrje që xhamia e re të frekuentohet me po atë zell, me të cilin u ndërtua dhe u plotësua, me mirësitë e Zotit.

Myftiu theksoi se xhamia nuk prodhon terrorizëm, as e nxit atë, përkundrazi, ajo është djep i besimit dhe i harmonisë, vendi ku brezat edukohen me moralin e bukur të fesë dhe ndjenjat më të larta të saj.

Ceremoninë e përshëndeti edhe



Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, i cili theksoi se ndërtimi i kësaj xhamie në këtë tokë, është shenjë hyjnore për dashurinë që Zoti ka për këta njerëz dhe tregues i vullnetit të Tij që feja islame të lulëzojë në tokën dhe vendin tonë.

I pranishëm në këtë ditë feste ishte edhe thirrësi islam me banim në ShBA, z. Burhan Fili. Në fjalën e tij, ai shprehu gëzimin dhe emocionet për këtë ditë të

begatë dhe vuri theksin te madhështia e mesazhit islam. “Çdo gjë në këtë botë e ka një datë skadimi, vetëm Islami nuk ka skadencë”, tha ai, duke tërhequr vëmendjen e të pranishmëve drejt investimit në jetë në shërbim të fesë dhe vlerave të saj.

Në shoqërimin e tekbiereve u bë edhe prerja e shiritit të inaugurimit dhe u bë falja e parë e namazit të mesditës me xhemat në xhaminë e re.

“VLERAT E TRE MUAJVE TË MIRË”, NË VAU DEJËS

Pasditen e së shtunës, më 9 maj 2015, Myftinia Shkodër, në bashkëpunim me Medresenë “Haxhi Sheh Shamia”, organizuan një aktivitet fetaro-kulturor në Vau Dejës.

Aktiviteti në fjalë, i pari në llojin e tij në këtë zonë është pjesë e tubimeve fetare, që Myftinia Shkodër po organizon me rastin e Tre Muajve të Mirë.

Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili vuri theksin te domosdoshmëria e ruajtjes së amanetit të fesë dhe qëndrueshmëria në udhën e saj. Myftiu tha se muslimani, pavarësisht realiteteve me të cilat përballet, e ruan me dinjitet dhe krenari përkatësinë e tij fetare. Ai dha disa këshilla të dobishme për muslimanët e kësaj zone dhe u angazhua se në të ardhmen, Myftinia Shkodër do të jetë më pranë muslimanëve të Bashkisë Vau Dejës.

Njëkohësisht tha se Vau Dejës është një zonë kryesisht e krishterë, por detyra e muslimanëve të saj është të përhapin vlerat e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërjetare dhe të jenë



faktor i rëndësishëm i ruajtjes dhe mbrojtjes së paqes sociale.

Ndërsa imami i xhamisë Parrucë, teologu Naim Drijaj mbajti një temë mbi vlerën e Tre Muajve të Mirë dhe shfrytëzimin e tyre në rrugëtimin hyjnor në jetë, si një mirësi nga Zoti për besimtarët e Tij.

Imami i nderuar tha se këto tre muaj janë një mundësi e mirë për t'u përgatitur si duhet për Muajin Ramazan dhe dëshmimin

e mrekullive të besimit në jetë.

Një program i larmishëm me recitime dhe ilahi, të mbushura me emocione besimi dhe malli për të dërguarin e All-llahut, Hz. Muhammedin (a.s), nga medresistët tanë plotësoi më së miri këtë aktivitet të dobishëm. Në përfundim, për të pranishmit u shpërnda Kur'ani Famëlartë, me përkthim të kuptimeve në gjuhën shqipe, dy libra mbi jetën e Hz. Muhammedit (a.s), si dhe revistat “Etika” dhe “Drita Islame”.

KONFERENCA MBI ETIKËN ISLAME TË BASHKËJETESËS NDËRFETARE

Pasditen e së shtunës, më 2 maj 2015, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me zyrën e Atasheut për Çështjet Fetare në Ambasadën e Turqisë, organizuan në sallën e konferencave të Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", konferencën me temë: "Përgamëri Muhammed (a.s) dhe etika e bashkëjetesës ndërfetare".

Fillimisht, të pranishmit patën mundësi të ndiqnin një film të shkurtër të përgatitur nga Dijanieti i Turqisë, në lidhje me vlerat e bashkëjetesës në mesin e njerëzve, në diversitetin e tyre fetar, kulturor e përtej tyre.

Konferenca u përshëndet nga Myftiu i Zonës Shkodër Imam Muhamed Sytari, që u ndal në tre momente historike, që pasqyrojnë më së miri qëndrimin e Islamit dhe muslimanëve në raport me jomuslimanët; priten që Resulull-llahu (a.s) i bëri delegacionit të krishterë të Nexhranit, qëndrimin e Hz. Omerit (r.a) ndaj peshkopit të Kudsit, kur ky i fundit i propozoi të falej në kishë dhe deklaratën e mrekullueshme të Sulltan Mehmet Fatihut, që i garantoj të drejta të plota të krishterëve dhe objekteve të tyre të kultit.

Myftiu falënderoi prezencën e



ambasadorit të Turqisë, z. Hidayet Bayraktar, koordinatori të TIKa-s, prof. dr. Birol Çetin, si dhe koordinimin e atasheut z. Shaban Ishlek.

Përshëndeti edhe ambasadori i Turqisë në vendin tonë, z. Hidayet Bayraktar, që theksoi se këto tubime kanë një vlerë të madhe, ku pasqyrohet më së miri vlera dhe humanizmi i mësimëve të Islamit, në ruajtjen e harmonisë dhe vlerave më të mira të bashkëjetesës për njerëzimin.

I ftuar special i kësaj konference ishte studiuesi turk, prof. dr. Hysejn

Yilmaz. Në kumtesën e tij, ai hodhi dritë mbi bazat e besimit dhe lidhjet e tij me marrëdhëniet e njeriut me tjetrin në jetë.

Prof. Yilmaz theksoi se Islami qëndron në një nivel të lartë, në përballjen e tij me diversitetin fetar dhe respektin ndaj njeriut, si krijesa më e përsosur e Zotit.

Në fund, përshëndeti edhe atasheu z. Shaban Ishlek, që shprehu falënderimet dhe mirënjohjen e tij për këtë organizim dhe bashkëpunimin me Myftininë e Shkodrës.

OBLIKË, TUBIM FETAR NË ATMOSFERËN E TRE MUAJVE TË MIRË

Paraditën e së dielës, më 10 maj 2015, në xhaminë e fshatit Oblikë, u organizua një tribunë fetare, në kuadër të përkujtimit të misionit hyjnor me të cilin u dërgua Hz. Muhammedi (a.s) dhe në atmosferën e Tre Muajve të Mirë.

Aktiviteti nisi me fjalën e imamit të xhamisë Oblikë, z. Ridvan Luzaku, i cili

vlerësoi tubimin e besimtarëve të kësaj xhamie, si shenjë besimi dhe përmallimi për mësimet e Islamit dhe mesazhet e tij.

Më pas, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, foli mbi rëndësinë e përkujtimit të personalitetit të Hz. Muhammedit (a.s), si shtysë besimi, sidomos për brezin e ri, për t'u afruar

përherë e më shumë me udhëzimin e tij dhe shembullin e përsosur, me të cilin u dërgua.

Myftiu theksoi se në realitetet e këtyre ditëve, është me shumë rëndësi të dëshmohet besimi dhe përkatësia e tij, si një dëshmi e shenjtë, e paprekshme dhe që nuk pranon asnjë tolerancë ndaj kujtdo, që përpiqet të prekë thelbin e saj me qëllime jo të mira.

Ai përmendi shembullin e Hz. Ibrahimit (a.s), si modeli i qëndrueshmërisë në besimi dhe mospërkuljes, as para vdekjes, në rrugën e shërbimit ndaj fesë së All-llahut dhe udhëzimit të tij.

Aktiviteti pasoi me këndimin e disa ilahive të bukura dhe pjesëve të "Mevludit", nga Hafiz Shukri Kapllan, H. Vehbi Dani dhe H. Sami Muçej dhe z. Nexhmi Guri.

Me këndimin e ezanit të mesditës, të pranishmit kryen edhe faljen e namazit me xhemat dhe këmbyen lutjet dhe urimet me rastin e këtij tubimi vlerash.



Paraditën e së martës, më 12 maj 2015, ka mbërritur për një vizitë të shkurtër jozyrtare në Shkodër, Myftiu i Stambollit, prof. dr. Rahmi Yaran, i shoqëruar edhe nga njëri prej zëvendësve të tij dhe dy nga imamët më të shquar të Stambollit.

Në mikpritje të tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka shprehur gëzimin e tij për këtë takim të përzemërt me Myftiun e nderuar të Stambollit, një personalitet i shquar islam në Turqi dhe përtej saj.

Gjatë takimit të përzemërt është diskutuar për tema të ndryshme, si dhe është vënë theksi te domosdoshmëria e angazhimit të përbashkët, në rrafsh ymeti, për afrimin e muslimanëve me njëri-tjetrin dhe largimin nga elementët përçarës dhe tendencat e ndarjes në familjen e madhe islame në botë.

Me rastin e këtij qëndrimi të shkurtër në Shkodër, Myftiu i Stambollit, i shoqëruar nga Myftiu i Shkodrës, ka zhvilluar një vizitë të shkurtër edhe në Medresenë “Haxhi

Familja dhe rinia përballë sfidave të modernitetit ishte tema rreth të cilës komunitetet fetare të Shkodrës organizuan një konferencë ndërfaqetare, ditën e mërkurë, më 13 maj 2015, në kinema “Millennium”, ku referues ishin përfaqësues të tre komuniteteve fetare të Shkodrës.

Kisha Ortodokse, Kisha Katolike dhe Myftinia Shkodër, iu drejtuan besimtarëve të tyre mbi këtë temë sa delikate aq edhe të domosdoshme për periudhën në të cilën jetojmë, ku familja kërcënohet vazhdimisht nga faktorë të cilët i dikton koha, e që marrin përkufizimin e periudhës moderne në të cilën jetojmë.

Krahas shumë besimtarëve, intelektualëve nga tre komunitetet fetare, merrnin pjesë edhe drejtues fetarë, përfaqësues të pushtetit lokal etj.

Përshëndetën këtë takim ndërfaqetar Atë Nikolla Petani, famullitar i Kishës Ortodokse Shkodër, Imzot Angelo Massafra, arqipeshkv Shkodër-Pult si dhe teologu Arben Halluni, përfaqësues i Myftinisë Shkodër, i cili lexoi përshëndetjen e Myftiut të Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari.

MYFTIU I STAMBOLLIT PËR VIZITË NË SHKODËR



Sheh Shamia”, me të dy degët e saj, ku është njohur me shkollën dhe angazhimet për përmirësimin e cilësisë së saj, në drejtim të rritjes progresive, duke u dëshmuar si një ndër shkollat më të mira në rangun e Qarkut Shkodër.

Gjatë vizitës në Medrese, ku ka dhënë edhe disa këshilla të dobishme për medresistët tanë, Myftiu i Stambollit është pritur nga drejtori, z. Kujtim Dervishi, si dhe nga koordinatoreja e Shoqatës “Istanbul”, znj. Elona Sytari.

NDËRFETARE, “FAMILJA DHE RINIA PËRBALLË SFIDAVE TË MODERNITETIT”



Më pas, Atë Nikolla Petani, Dom Marian Gega dhe Imam Lavdrim Hamja, ligjëruan rreth temës së kësaj konference, duke hedhur dritë mbi vlerat e rinisë dhe familjes, si dhe ruajtjes së duhur që duhet treguar përballë sfidave të ndryshme të kohës.

Takimi u shoqërua edhe me recitime poetike nga aktori i mirënjohur

shkodran, Agron Dizdari, si dhe nga Paulin Ujkaj.

Siç u premtua nga përfaqësuesit e komuniteteve fetare të Shkodrës takime të tilla ndërfaqetare për tematika të ndryshme sociale dhe kulturore do të vijojnë edhe në të ardhmen më qëllim parandalimin e fenomeneve negative më të cilat përballen shoqëritë e ndryshme.

Ditën e dielë, më 3 maj 2015, u nda nga jeta e kalimtare e kësaj bote në moshën 81 vjeçare, i nderuari z. Hilmi Hoxha, një besimtar i përkushtuar dhe një mësues i palodhur në rrugën e mësimit të leximit të Kur'anit, në xhami të ndryshme të Shkodrës.

Haxhi Hilmija, siç thirrej nga besimtarët frekuentues të xhamive të Shkodrës, sidomos ata të Parrucës, të Rusit dhe xhamisë "Ebu Bekër", ishte një njeri i heshtur dhe shumë i pasionuar pas mësimit të leximit të Kur'anit.

Janë të panumërt nxënësit e tij, që mësuan leximin e Fjalës së All-llahut nga përkushtimi dhe këmbëngulja e tij, ashtu në heshtje dhe pa kërkuar e pranuar asnjëherë asnjë falënderim a mirënjohje nga dikush.

Në ceremoninë e xhenazes së tij, që u drejtua nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, u theksua se shembulli i H. Hilmi Hoxhës duhet të ngelet një model frymëzimi, sidomos për teologët, imamët dhe shërbyesit e ndryshëm në rrugën e gjallërimit të Thirrjes Islame në xhamitë e Shkodrës dhe përtej tyre.

Myftiu ngushëlloi familjarët e të

NË RAHMET TË ALL-LLAHUT, H. HILMI HOXHA



ndjerit, duke thënë se ata duhet të ndjehen krenarë për babën e tyre dhe shembullin e lartë që ai la, pas largimit nga kjo botë. "Ai ishte një shërbyes i heshtur i Fjalës së All-llahut, prej atyre, që asnjëherë nuk dimë se ka kërkuar lëvdata a falënderime. Ishte modeli i njeriut asket e sakrifikues në rrugën e besimit dhe Fjalës së Zotit"-tha Myftiu.

Njëkohësisht, në talkinën e mbajtur nga H. Fejzi Zaganjori, imami i xhamisë së Rusit, shprehu nderimet

dhe mirënjohjen e tij për këtë njeri të urtë dhe mësues të respektuar, që ka pasur një kontribut të shquar, sidomos me xhematin e xhamisë së Rusit, ku ka mësuar me dhjetëra nxënës, me një vullnet të pashembullt.

Më herët, H. Shukri Kapllan dhe imamët e pranishëm lexuan një "Jasin-i Sherif" për shpirtin e tij, si dhe bënë lutje që All-llahu ta pranojë në mëshirën e Tij dhe ta shpërblejë për shembullin dhe përkushtimin e tij në këtë botë.

Në kuadër të aktiviteteve të larmishme, në atmosferën e 25-vjetorit të rilejimit të besimit fetar në Shqipëri, si dhe në vazhdën e aktiviteteve fetare e kulturore me rastin e hyrjes së Tre Muajve të Mirë, ditën e shtunë, më 16 maj 2015, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet të dobishëm më nxënës të kurseve fetare të disa xhamive të Shkodrës, në kalanë "Rozafa".

"Të edukohemi me Islamin", ishte titulluar ky aktivitet, në të cilin përfshiheshin lojra popullore, konkurse në mesin e nxënësve, lutje e këshilla fetare nga mësuesit e kurseve dhe imamët e nderuar të pranishëm në këtë aktivitet.

Aktiviteti në oborrin e xhamisë së kalasë së Shkodrës, filloi me leximin e disa ajeteve nga Kur'ani Famëlartë, nga një prej nxënësve të dalluar të kurseve tona fetare.

Më pas teologu Arben Halluni, përgjegjës i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, mbajti një bisedë të dobishme me këshilla të vyera dhe lutje për të

AKTIVITETI: "TË EDUKOHEMI ME ISLAMIN"...



pranishmit. Në bisedën e tij, ai uroi dhe përgëzoi pjesëmarrjen e madhe të nxënësve (mbi 500 nxënës dhe nxënës të xhamive tona), duke shprehur falënderimet e tij ndaj All-llahut (xh. sh) për këtë mirësi të madhe që ka sjellë tek ky brez i ri.

Ai uroi që aktivitete të tilla, ku shfaqet më së miri fryma e harmonisë islame dhe e vëllazërisë në mesin e nxënësve të krejt xhamive të Shkodrës,

të jenë sa më të shumta.

Për rreth katër orë, fëmijët kanë marrë pjesë në lojra të shumta popullore, të mirëorganizuara, si dhe kanë ndarë së bashku kënaqësinë e faljes së namazit të Duhasë, nën drejtimin e teologut Arben Halluni.

Aktiviteti është shoqëruar edhe me këndimin e ilahive të shumta, vizitën e kalasë dhe muzeut të saj.



H. Fejzi Zaganjori
Imam, xhamia Rus

Unda nga kjo botë materiale, nga jeta e kësaj dynjaje, burri i urtë, i butë, gojëmbël, durimtar, një njeri fjalë pak e punë shumë, që i kushtoi jetën çdo gjëje të mirë, e mbi të gjitha besimit tek i Madhi Zot dhe dashurisë për hz. Muhammed Mustafanë (a.s).

Hilmi Hoxha i përkiste familjes së nderuar Hoxha, i biri i të ndjerit, Sheh Qazim Hoxha. Haxhi Hilmi Hoxha mësimet e para fetare i mori prej nënës, duke vazhduar më tej me babain e tij, shehun e nderuar dhe shpejt, që në fëmijëri arriti, që të kryejë ritet fetare në shtëpi dhe shpesh në xhami.

Haxhi Hilmi Hoxha nuk vazhdoi shkollë fetare, por ambienti i tij familjar, i impononte dëshirën, që të mësonte dituri fetare dhe këtë ai e bënte në mënyrë autodidakte. Haxhi Hilmiu karakterizua gjatë jetës së tij, si njeri i punës, i dashurisë për gjithçka, i larguar nga çdo veprim negativ, të ndaluar nga feja Islame.

Ai ishte një njeri që me vullnetin e tij të fortë do ta kishin dëshirë shumë njerëz, dhe me këtë vullnet ai arrinte të plotësonte çdo detyrë, kudo që punoi, deri sa e dorëzoi shpirtin me 2 maj 2015, në moshën 81 vjeçare.

Datën 16 nëntor 1990, jo vetëm e priti me kënaqësi të madhe, por u aktivizua menjëherë, pa e ftuar askush dhe riaktivizoi energjitë e tij shpirtërore me një përkushtim të paimagjinueshëm, duke i ftuar besimtarët, pavarësisht nga mosha, gjinia, apo arsimi dhe i merrte për doret duke iu mësuar abetaren e Kur'anit, qoftë në mënyrë individuale, apo edhe në grupe.

NDËRROI JETË MËSUESI I KUR'ANIT, HAXHI HILMI HOXHA

"Më i miri ndër ju është ai që e mëson Kur'anin dhe ia mëson atë edhe të tjerëve." - Hz. Muhammed (a.s)

Shumë vite kaluan dhe shumë besimtarë mësuari të lexonin Kur'anin në gjuhën arabe dhe shumë prej këtyre morën pjesë dhe vazhdojnë të marrin pjesë në leximin e mukabeles.

Ai ndjente kënaqësi kur i mësonte të tjerët, ai gëzohej kur i kërkonin që tua mësonte Kur'anin, ai porosiste imamët dhe hatibët në çdo ditë xhuma që prej minbereve të ftonin besimtarët dhe besimtare të



mësojnë leximin e Kur'anit të Madhërueshëm.

Çdo ditë që ai bënte mësim në xhami rinohej dhe fliste me optimizëm për të ardhmen e Islamit. Kështu dalëngadalë Haxhi Hilmiu u bë mësuesi i xhemateve të Shkodrës. Gëzohej shumë kur nxënësit e tij e lexonin mirë Kur'anin, rrjedhshëm sipas rregullave, por nuk përtonte të ndalej e të korrigjonte gabimet dhe asnjëherë nuk mërzhitej.

Ai ishte një besimtar i bindur, i pafjalë. Ai u bë me kuptimin e plotë një zahid (asket), që jetën tashmë ia kishte dedikuar vetëm Allahut (xh. sh) e askujt tjetër.

Edhe pse gjatë viteve të fundit mjekët e këshillonin të mos lodhej, të mos dilte në mot të ftohtë, apo të nxehtë, ai e gjente kohën për të mos munguar në orët e planifikuara me

nxënësit. Haxhi Hilmi Hoxha ishte një drejtues i mirëfilltë i mukabeles në xhami të Rusit. Qëndronte rreth dy orë i përqendruar tek Kur'ani dhe shpesh ndalej për të ndërhyrë, se si duhet kjo apo ajo, dhe asnjëherë nuk shfaqte asnjë lloj mërzie.

Haxhi Hilmiu ishte shembull i njeriut në durim, ai nuk e njihte fjalën ankesë për asgjë dhe thoshte: "Nëse ankohesh del kundra vullnetit të të Madhit Zot dhe sprovave të Tij".

Haxhi Hilmi Hoxha ishte një mësues që nuk kishte mësuar pedagogji, ai kishte pedagogji dëshirën e mirë, sjelljen, dashurinë, traditën e familjes si mësues të Kur'anit e të besimit me breza.

Vërtet u largua nga kjo jetë ky njeri me vlera, një prind shembullor, një bamirës, një besnik i Islamit, një bashkëshort i denjë, vëlla i çdokujt. Ai do të mbetet i paharruar dhe do të kujtohet nga të gjithë, nga nxënësit, të cilët e deshën aq shumë, nga imamët që e nderuan, nga teologët, të cilët e respektuan, nga myftilerët të cilët e përkrahën në nismën e tij, nga besimtarët për konsideratën që kishin dhe nga familja e tij.

Dashuria për Haxhi Hilmi Hoxhën u shpreh me heshtje në ditën e përcjelljes për në banesën e fundit me një pjesëmarrje të madhe nga breza e shtresa të ndryshme shoqërore.

Fjala e mbajtur në oborrin e xhamisë "Ebu Bekr" në faljen e xhenazes, nga kryemyftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, e vulosi respektin për punën vetëmohuese të këtij mësuesi të Kur'anit, si dhe lutja e tij që i Madhi Zot ta shpërblejë me shpërblimet më të mira.

I Madhi Zot qoftë i kënaqur prej tij dhe i dhuroftë rahmetin e përherëshëm dhe xhenetin Firdeus.



المشيخة الإسلامية الألبانية
دار الإفتاء - مدينة شكوذرا
KOMUNITETI MUSLIMAN I SHQIPËRIE
MYFTINIA SHKODËR

"Thotë All-llahu i Madhëruar:
Namazin do ta pranoj nga ai që është i përvulur para Madhërisë Sime,
që nuk është arrogant ndaj krijesave të Mia.
Nga ai që e kalon ditën me dhikrin Tim,
që nuk është insistues në gabimet e tij.
Nga ai, që ushqen të uriturin dhe strehon të huajt,
që mëshiron të voglin dhe respekton të madhin.
Ky është ai, që kur të më kërkojë, do t'i jap,
kur të lutet, do t'i përgjigjem, kur të më përgjërohet, do ta mëshiroj.
Shembulli i tij tek Unë, është si shembulli i Firdausit,
ndër xhennete; fruitet e tij nuk ndryshojnë, gjendja e tij nuk ndryshon!"

- Transmetuar nga Darekutniu, nga Ali ibn Ebi Talib (r.a) -

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja
Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org